



VENDIM

Nr. 10, Datë 25/10/2016

PËR

MIRATIMIN E PLANEVE MËSIMORE NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA
PËR VITIN AKADEMIK 2016 - 2017

Në zbatim të, nenit 3, (*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*), neni 38 (*Funksionet e Senatit Akademik*), neni 39 (*Rektori*), të ligjit nr. 80/2015, "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", dhe pasi u njoh me dokumentacionin e dërguar nga Fakulteti i Arteve të Bukura, si dhe të prezantuar nga Drejtuesit e Departamenteve, ku gjendeshin të përfshira të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve, për vitin akademik 2016-2017,

VENDOSI

1. Miratimin e planeve mësimore të Fakultetit të Arteve të Bukura, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve, për vitin akademik 2016-2017 sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi të dërguar nga Fakulteti i Arteve të Bukura.
2. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Arteve të Bukura, Sekretaria mësimore dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve;
3. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Prof. Kastriot ÇAUSHI *[Signature]* **Prof. Dr. Zana SHËTERIQI (PRELA)** *[Signature]*

Prof. Dr. Isak SHEHU *[Signature]* **Prof. Petrit MALAJ**

Prof. Asoc. Ardian ISUFI *[Signature]* **Prof. Sadik SPAHIJA** *[Signature]*

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA) *[Signature]* **Prof. Najada HAMZAJ** *[Signature]*

Prof. Fatmir MIZIRI *[Signature]* **Prof. Ilir MARTINI** *[Signature]*

Prof. Gazmend GJOKA *[Signature]* **Prof. Miltiadh KUTALI**

Prof. Petrika AFEZOLLI *[Signature]* **Prof. Bujar SYKJA** *[Signature]*

Prof. Dr. Erald BAKALLI *[Signature]* **Prof. Asoc. Elvis RUDI** *[Signature]*

Prof. Asoc. Albes FUSHA *[Signature]* **Nansy GJERAZI**

Rafael HOXHA *[Signature]*